

## UPCOMING EVENTS | IMPORTANT DATES

**April 22-26 | Hannover Messe 2024**

**April 24-25 | FIBE-Fintech Berlin**

**April 26 | Investing in Kosovo: Business opportunities and market entry for companies**, by KDWW in IHK-Bezirksskammer Göppingen

**April 30 | New Members Day**, by KDWW

**SAVE THE DATES:**

**October 1 | SUBEX 2024**

**October 2-3 | 2<sup>nd</sup> German-Kosovar Economic Forum**, by KDWW

[Fairs in Germany](#)

**Të nderuar anëtarë të Odës Ekonomike Gjermano-Kosovare,**

Në këtë edicion të Newsletter, ju sjellim përmbledhjen më të fundit të lajmeve të aktiviteteve tona si dhe partnerëve; nga eventit publikues i Analizës “Challenges of Accessing the Labour Market - Middle-Aged Women in Kosovo”, takimet e Klasterëve, Business Brunch me kompani anëtare dhe përfaqësues të Ministrisë së Ekonomisë dhe Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, votimi për anëtarësinë e Kosovës në KiE, e deri tek fondet e ndara nga BE dhe Banka Botërore.

Ju falenderojmë që jeni pjesë e komunitetit tonë!

**Dear members of the German-Kosovar Business Association,**

In this edition of our Newsletter, we bring to you the latest summary of news from our activities and our partners; from the publication event of the Analysis “Challenges of Accessing the Labour Market - Middle-Aged Women in Kosovo”, the Cluster meetings, Business Brunch with member companies from the ICT and E-Commerce sectors and representatives of the Ministry of Economy and the Ministry of Industry, Entrepreneurship and Trade, the voting of Kosovo’s membership in the CoE, and the funds from the EU and the World Bank.

We thank you for being a part of our community!

**Publikohet Analiza “Sfidat e Qasjes në Tregun e Punës – gratë në moshën e mesme”**

Për të analizuar barrierat për qasje në tregun e punës tek gratë e moshës së mesme 40-65 vjeçare, si: diskriminimin gjinor, mungesën e qasjes në mundësitë e arsimit dhe trajnimit, normat kulturore, mundësitë e kufizuara të punës, dhe balancimi i punës me përgjegjësitë familjare, OEGJK bashkë me fondacionin gjerman Friedrich-Naumann-Stiftung für die Freiheit (FNF), publikuan Analizën “Sfidat e Qasjes në Tregun e Punës – gratë e moshës së mesme”.

**Analysis "Challenges of Accessing the Labour Market - Middle-aged Women" was published**

To analyze the barriers of accessing the labour market for middle-aged women aged 40-65, such as gender discrimination, lack of access to educational and training opportunities, cultural norms, limited job opportunities, and balancing work with family responsibilities, the German-Kosovar Business Association, in collaboration with the Friedrich-Naumann-Stiftung für die Freiheit (FNF), published the Analysis "Challenges of Accessing the Labor Market - Middle-aged Women."

Autore: Dr. Saxhide Mustafa dhe Shqipe Gjocaj.

Authors: Dr. Saxhide Mustafa and Shqipe Gjocaj.

Në prezencë të Zëvendësministrit të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, Agon Dobruna, deputetit të Kuvendit të Kosovës Besnik Tahiri, kompanive anëtare, përfaqësuesve të fondacioneve gjermane në Kosovë, institucioneve vendore dhe ndërkombëtare u prezantuan të gjeturat dhe rekomandimet nga kjo analizë.

In the presence of the Deputy Minister of Finance, Labour and Transfers, Agon Dobruna, Member of the Kosovo Assembly, Besnik Tahiri, member companies, representatives of German foundations in Kosovo, local and international institutions, the findings and recommendations from this analysis were presented.

Raportin i plotë është i çashëm për publikun dhe e gjeni si në vijim: [Challenges of Accessing the Labor Market | Friedrich-Naumann-Stiftung \(freiheit.org\)](#)

You can find the full report in the link as follows: [Challenges of Accessing the Labor Market | Friedrich-Naumann-Stiftung \(freiheit.org\)](#)

---

### **OEGJK mbajti takimet e Klasterëve**

### **KDWV held its Cluster meetings**

Gjatë kësaj jave u mbajtën takimet e Klasterëve të Odës Ekonomike Gjermano – Kosovare, ku u diskutua rreth sfidave të sektorëve respektivë dhe hapat që do të ndërmerren tutje.

During this week, the meetings of Clusters of the German - Kosovar Business Association were held, where challenges in respective sectors and further steps were discussed.

### **Business Brunch: Takimi i përbashkët i Klasterëve për ICT dhe E-Commerce**

### **Business Brunch: The joint meeting of the Clusters for ICT and E-Commerce**

Me datë 16 prill, u mbajt Business Brunch me përfaqësues të kompanive anëtare të sektorit të ICT dhe E-commerce dhe të ftuarit Mentor Arifaj, Zëvendësministër i Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë dhe Agim Kurtaj, Drejtor i Departamentit të Teknologjisë Informative dhe Komunikuese (TIK), Ministria e Ekonomisë.

On April 16<sup>th</sup>, a Business Brunch was held with representatives of member companies from the sectors of ICT and E-Commerce and the guests, Mr. Mentor Arifaj, Deputy Minister of the Ministry of Industry, Entrepreneurship and Trade and Mr. Agim Kurtaj, Head of Department of Information and Communication Technology (ICT), Ministry of Economy.

Diskutimet u përqëndruan tek disa prej temave me fokus të këtyre sektorëve si: rëndësia e hartimit të Ligjit për Tregti Elektronike, mungesa e Top Level Domain si dhe funksionalizimi i nënshkrimit digjital.

Discussions focused on some of the most important topics for these sectors, such as: the importance of drafting the Law on E-Commerce, the lack of the Top Level Domain as well as the operationalization of the digital signature.

Në këto tema, rekomandime konkrete ofruan përfaqësues të kompanive anëtare, ekspertë ligjorë të ekonomisë, ICT-së dhe sigurisë kibernetike, ku u theksua edhe rëndësia e themelimit të një taskforce digjitale për tregti elektronike.

Representatives of member companies, legal economy experts, ICT and cybersecurity experts gave their concrete recommendations on these topics, where the importance of the establishment of a digital taskforce for e-commerce was highlighted.

---

Ndër të tjera, pjesëmarrësit u njoftuan rreth projektit për nënshkrimin digjital, i cili pritet të zbatohet nga shtatori i këtij viti.

Ky event u mbështet nga kompanitë anëtare DHL dhe BorekSolutions.

Among others, participants were notified on the project for the digital signature, which is expected to be implemented from September of this year.

This event was supported by member companies DHL and Borek Solutions.



### **Takimi i Klasterit për Energji të Ripërtëritshme**

Me datë 17 prill u mbajt takimi i Klasterit për Energji të Ripërtëritshme.

Gjatë takimit u diskutua për çështje të ndryshme si: kyqja në rrjet, politikat net-zero, nevoja e aftësimit të fuqisë punëtore në sektorin e energjisë dhe ndërlidhja e të fundit me objektivat e Klasterit për Arsim dhe Aftësim Profesional.

Anëtarët në këtë takim u dakorduan për aktivitetet e radhës së Klasterit.

### **Takimi i Klasterit për Tatime dhe Taksa me Sami Salihu, Zëvendës drejtor i ATK-së**

Takim i Klasterit për Tatime dhe Taksa u mbajt me datë 18 Prill, ku mori pjesë dhe Zëvendës drejtori i Përgjithshëm i ATK-së, z. Sami Salihu.

### **Cluster Meeting for Renewable Energy**

On April 17<sup>th</sup>, the meeting of the Cluster for Renewable Energy was held.

During the meeting, various issues were discussed such as: including accessing the power grid, net-metering, the need for workforce training in the energy sector and the link of the last issue to the objectives of the Cluster for dual Vocational Education and Training.

Members agreed on the Clusters' next activities.

### **Cluster Meeting for Taxes with Sami Salihu, deputy Director of TAK**

the Cluster meeting for Taxes was held on April 18<sup>th</sup>, where present was the Deputy General Director of TAK, Mr. Sami Salihu.

Të pranishmit patën rastin të diskutojnë tema me interes me z.Salihu. U diskutua mbi ndryshimet që do të sjellë Ligji i ri për Administrimin e Procedurave Tatimore (Ligji Nr. 08/L-257), i cili ka hyrë në fuqi në janar të këtij viti.

The attendees had the chance to discuss topics of interest with Mr. Salihu. The changes that the new Law on the Administration of Tax Procedures (Law No. 08/L-257), which entered into force in January of this year will bring, were also discussed.

Anëtarët ndanë opinionet e tyre mbi këtë ligj dhe diskutuan mbi mbarëvajtjen e proceseve teknike në ATK.

Members shared their opinions on this law and discussed the progress of technical processes in TAK.

---

### **BE garanton zhbllokimin e 37 milionë eurove për bizneset e vogla në Kosovë.**

### **EU guarantees to unlock €37 million for small businesses in Kosovo.**

Fondi Evropian i Investimeve (EIF), i cili është pjesë e Grupit të Bankës Evropiane të Investimeve (EIB), ka nënshkruar marrëveshje garancie të portofolit me 11 banka dhe ndërmjetës financiarë në ekonomitë e vendeve të Ballkanit Perëndimor.

The European Investment Fund (EIF), which is part of the European Investment Bank (EIB) Group, has signed portfolio guarantee agreements with 11 banks and financial intermediaries in the economies of the Western Balkan countries.

Kjo marrëveshje për Ballkanin Perëndimor do tu mundësojë bankave dhe institucioneve financiare të rajonit të krijojnë një portofol kredish për biznese të vogla dhe të mesme për një shumë totale mbi 750 milionë euro. Në Kosovë, ky burim financiar pritet të sjellë rreth 37 milionë euro kredi për 690 biznese të vogla dhe të mesme, duke mbështetur rreth 9500 vende pune.

This agreement for the Western Balkans will enable banks and financial institutions of the region to create a loan portfolio for small and medium businesses for over 750 million euros. In Kosovo, this financial resource is expected to bring nearly 37 million euros in loans to 690 small and medium-sized businesses, supporting around 9,500 jobs.

Këto burime financiare të krijuara kanë qëllim të rrisin aksesin në financa për bizneset e vogla dhe të mesme dhe të mbështesin qëndrueshmërinë ndaj vështirësive ekonomike. Njëkohësisht do të krijohen kushte për zgjerim të biznesit si dhe punësime të reja.

These created financial resources have the purpose of increasing access to finance for small businesses and mid-size businesses and aid in resilience against economic difficulties. At the same time, more favorable conditions for business' expansion and new employment will be created.

Bizneset e vogla të Kosovës kanë përfituar rreth 190 milionë euro në fonde nga Fondi Evropian i Investimeve deri tani.

Kosovo's small businesses have benefited about 190 million euros in funds from the European Investment Fund so far.

---

### **Asambleja Parlamentare rekomandon anëtarësimin e Kosovës në Këshillin e Evropës**

### **The Parliamentary Assembly (PACE) recommends the membership of Kosovo in the Council of Europe**

Me 16 prill, Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës ka votuar pro rekomandimit të Kosovës në Këshillin e Evropës.

On April 16<sup>th</sup>, the Parliamentary Assembly of the Council of Europe voted in favor of the recommendation of Kosovo to the Council of Europe.

---

Me 131 vota për, 29 kundër dhe 11 abstenime, anëtarësimi i Kosovës në KiE ka pranuar mbështetje nga 76.6 % të Asambleistëve.

Pas votimit të Asamblesë Parlamentare, hapi i radhës është votimi nga ministrat e jashtëm të KiE, të cilët duhet të vendosin nëse Kosova do të bëhet anëtarja më e re e organizatës.

Këshilli i Evropës ka 46 shtete anëtare, përfshirë të gjitha 27 shtetet anëtare të Bashkimit Evropian.

With 131 votes in favor, 29 against and 11 abstentions, the membership of Kosovo in the Council of Europe has received support from 76.6 % of the Assembly members.

After the voting of the Parliamentary Assembly, the next step is the vote by the foreign ministers of the Council of Europe, who must decide whether Kosovo will become the newest member of the organization.

The Council of Europe has 46 member states, including all 27 member states of the European Union.

### **Kosova merr 90 milionë euro financim nga Banka Botërore**

Ministri i Financave, Hekuran Murati dhe zv. Presidentja e degës Evropë dhe Azi Qëndrore në Bankën Botërore, Antonella Bassani, kanë nënshkruar marrëveshjen për Financimin e Politikave Zhvillimore për Politikën Fiskale, Konkurrueshmërinë dhe Rritjen e Gjelbër ndërmjet Kosovës dhe Bankës Botërore.

Financimi arrin vlerën 90 milionë Euro dhe u bë i mundur pasi Kosova ka zbatuar veprimet e dakorduara me Bankën Botërore si forcimi i stabilitetit fiskal dhe makroekonomik, rritja e efikasitetit të shpenzimeve publike, krijimi i një ambienti të favorshëm për investime dhe fillimi i tranzicionit drejtë një ekonomie të gjelbërt.

### **Kosovo receives 90 million Euro in financing from the World Bank**

The minister of Finance, Hekuran Murati, and the vice President of the Europe and Central Asia, branch of the World Bank, Antonella Bassani, have signed the Financing of Developmental Politics for Fiscal Politics, Competitiveness and Green Growth agreement between Kosovo and the World Bank.

The financing reaches 90 million Euros in value and became possible after Kosovo implemented the agreed-upon actions with the World Bank such as strengthening the macroeconomic and fiscal stability, increasing the efficiency of public spending, creating a favorable environment for investing and starting the transition toward a green economy.



**YOUR CONTACT PERSONS AT KDWV**

**BOOK YOUR APPOINTMENT AT KDWV-OEGJK:**

ICON Tower, 9th Floor, "Bekim Fehmiu" Str., no. 110; 10000 Prishtina

Monday – Friday | 8.30 – 16.30




**Greta Kazia**

HR, Përgjegjëse për Financa dhe Anëtarësi

HR, Responsible for Finance and Membership

[greta.kazia@oegjk.org](mailto:greta.kazia@oegjk.org)



**Elena Elshani**

Asistente Ekzekutive

Përfaqësuese për Shërbimin e Ekspertëve Seniorë (SES)

Executive Assistant

Senior Expert Service Representative (SES)

[elena.elshani@oegjk.org](mailto:elena.elshani@oegjk.org)



**Besarta Hyseni**


Udhëheqëse e Departamentit mbështetje dhe shërbime të anëtarëve

Këshilltare për Arsim Profesional Dual

Head of Market Entry & Events

Advisor for VET

[besarta.hyseni@oegjk.org](mailto:besarta.hyseni@oegjk.org)




**Eriola Muhaxhiri**

Udhëheqëse e Departamentit për Avokim dhe Marrëdhënie Qeveritare

Head of Department for Advocacy and Government Relations

[eriola.muhaxhiri@oegjk.org](mailto:eriola.muhaxhiri@oegjk.org)




**Jeta Sylja**

Asistente Projekti

Project Assistant

Department for Market Entry & Events

[jeta.sylja@oegjk.org](mailto:jeta.sylja@oegjk.org)



**Rreze Gashi**

Koordinatorë

Coordinator

Department for Advocacy and Government Relations

[rreze.gashi@oegjk.org](mailto:rreze.gashi@oegjk.org)